



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Faruk Prebeza, udhëheqës i ekipit si dhe Parim Kryeziu, anëtar i ekipit.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	13
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	15

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli – kontrollet në ZRRE mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, me përjashtim të raportimit të obligimeve të papaguara.

Zbatimi i rekomandimeve - ZRRE kishte adresuar rekomandimin nga viti kaluar lidhur me menaxhimin e pasurisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

U.D Kryesuesi i Bordit është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do të adresoj rekomandimin e dhënë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e ZRRE-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga ZRRE-ja. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryesuesi i Bordit dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZRRE-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ZRRE në përgjithësi sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrolli kishte procese të mira të rishikimit dhe siguri në zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Megjithatë, nevojiten kontrolle të duhura sa i përket raportimit të obligimeve të papaguara dhe kryerjes së pagesave më kohë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	836,789	728,118	699,215	96%	648,075	592,128
Granti i Qeverisë - Buxheti	836,789	728,118	699,215	96%	648,075	592,128

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 108,671€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2019, ZRRE ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 699,215€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2018.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	836,789	728,118	699,215	96%	648,075	592,128
Pagat dhe Mëditjet	523,457	476,397	476,397	100%	457,599	416,031
Mallrat dhe Shërbimet	219,332	205,332	184,955	90%	167,443	149,256
Shërbimet komunale	22,000	16,389	15,090	92%	14,638	18,196
Investimet Kapitale	72,000	30,000	22,773	76%	8,396	8,645

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 47,060€:
- Zvogëlim të buxhetit final kishte edhe te kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 14,000€, si dhe për shërbimet komunale në vlerë 5,611€; dhe
- Po ashtu edhe te kategoria e investimeve kapitale kishte zvogëlim të buxhetit për vlerën 42,000€.

Ky zvogëlim i buxhetit ishte me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 03/115 të datës 17.12.2019.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ZRRE në 2019 ishin në vlerë 1,329,192€. Ato kanë të bëjnë me taksat vjetore të licencimit për gjenerim të ngrohjes, taksa vjetore e licencimit për gjenerim të energjisë elektrike, taksë për energjinë e importuar dhe taksë për shqyrtim të aplikacionit për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	-	-	1,329,192	1,217,436	1,412,853
Totali	-	-	1,329,192	1,217,436	1,412,853

Të hyrat e arkëtuara nga ZRRE krahasuar me vitin e kaluar ishin rritur për 9%. Këto të hyra transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK). Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 476,397€, aq sa edhe ishin shpenzuar. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 36 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 31. Gjatë vitit 2019 nuk ishin punësuar të rinj. Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 54,510€, si dhe 9 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 205,332€, ndërsa ishin shpenzuar 184,955€. Te shpenzimet komunale buxheti ishte 16,389€, prej të cilave ishin shpenzuar 15,090€. Në këto kategori shpenzimet kanë të bëjnë me: furnizim me kompjuterë, shpenzime për udhëtime zyrtare, shpenzime për telefoni mobile, shpenzime të qirasë, shpenzime të mirëmbajtjes, shpenzime komunale dhe shpenzime të tjera.

Për këto shpenzime, kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 45,614€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 30,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 22,773€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për blerje të pajisjeve të IT-së.

Gjatë viti ka qenë vetëm një pagesë në vlerë 22,773€, të cilën ne e kemi testuar për qëllime substanciale si dhe të njëjtën për teste të pajtueshmërisë. Nga mostra e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 29,331€, pasurive jokapitale është 31,439€, si dhe e stoqeve 5,654€.

Për menaxhimin e pasurive, ne kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 22,773€ si dhe tri mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

2.3 Të arkëtueshmet

ZRRE-ja në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 65,186€. Kjo vlerë përbehet nga 43,849€, fatura të lëshuara në muajin dhjetor 2019, që priten të arkëtohen në vitin 2020, ndërsa pjesa tjetër prej 21,337€ janë të arkëtueshme nga vitet e paraprake. Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar në këtë fushë.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 10,399€³. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Lidhur me testet tona, ne kemi vërejtur si në vijim:

³ Kjo është prezantuar nga entiteti i audituar

Çështja A1 - Vonesë në pagesë dhe dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 dhe 6, citon që raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në afat prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak. Kurse sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1, të LMFP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të faturës.

ZRRE kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo në 3 fatura në vlerë 5,156.40€, ne kemi vërejtur që ato ishin detyrime në muaj të caktuar mirëpo siç kërkohet me rregulloren e obligimeve ato nuk ishin raportuar si të tilla në MF. Madje prej tyre kishte vonesa nga pesë deri në 10 ditë, përtej afatit 30 ditë të lejuar.

Ndikimi Vonesa në pagesa dhe mos raportimi në kohë i obligimeve mujore ndikon në raportim jo të drejtë si dhe rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë.

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve të kontingjente e paraqitur në PFV ishte 0.00€⁴ Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar në këtë fushë.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 20,731€⁵. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar në këtë fushë.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave ligjore, ZRRE nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Ne vazhdojmë të inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që

⁴ Kjo është prezantuar nga entiteti i audituar

⁵ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm. Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar në këtë fushë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 ka rezultuar me një rekomandim. ZRRE-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi dhe kishte zbatuar rekomandimin e dhënë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si është trajtuar ai, shih tabelën në vijim:

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që menaxhimi i pasurisë jo kapitale bëhet konform rregullës përkatëse dhe duke funksionalizuar sistemin e-pasuri. Po ashtu, duhet të bëhet harmonizimi i gjendjes së pasurive në mes regjistrit të pasurisë dhe raportit të inventarizimit të pasurive, në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejtë në PFV.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprime dhe këtë vit nuk kemi identifikuar ndonjë dobësi.	I zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Detyrimet e papaguara	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keq deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keq deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 178/23
Data 27.05.20

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2019 dhe për
implementimin e rekomandimeve

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Z. Arsim Janova

UD Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Data: 27 maj 2019

Prishtinë